



RREGULLORJA NR. 2002/3

MBI TATIMIN NE FITIM NE KOSOVE

Përfaqsesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autoritetin e dhënë atij sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 Qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren Nr.1999/1 të datës 25 Korrik 1999 të Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), pas ndryshimeve, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren Nr.1999/16 të UNMIK-ut të datës 6 Nëntor 1999, pas ndryshimeve, mbi Autoritetin Qëndror Fiskal dhe Çështje të Tjera të Lidhura, dhe Rregulloren Nr.2000/20 të UNMIK-ut të datës 12 Prill 2000 mbi Administratën dhe Proçedurat Tatimore,

Duke marrë parasysh autoritetin përfundimtar të Përfaqsesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas paragrafit 8.1 (c) të Rregullores Nr.2001/19 të UNMIK-ut të datës 15 Maj 2001, mbi një Kornizë Kushtetuese për Vetë-Qeverisje të Përkohshme në Kosovë, për të përcaktuar parametrat financiare dhe politike për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, si edhe faktin se Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse nuk janë ndërtuar plotësisht dhe nuk kanë mundësi që nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Fiskal të japin këshilla mbi çështje të mbuluara nga kjo rregullore,

Me qëllim të vendosjes së Tatimit në Fitim,

Nëpërmjet kësaj Rregulloreje shpall sa vijon:

KAPITULLI 1 – DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje:

“Organizatë biznesi” nënkupton:

- (a) Një shoqëri kolektive, një shoqëri komandite, një shoqëri aksionare apo një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të themeluar sipas Rregullores Nr. 2001/6 të UNMIK-ut, të datës 8 Shkurt 2001, mbi Organizatat e Biznesit, dhe
- (b) Një organizatë biznesi që operon me asete shoqërore ose publike.

“Divident” nënkupton një shpërndarje nga kompania për një aksioner:

- (a) Të parave të gatshme ose aksioneve në lidhje me interesin e aksioneve të aksionerit në kompani; dhe
- (b) Të pasurisë përveç parasë se gatshme (cash) apo aksioneve përveç kur kjo vjen si rezultat i likuidimit.

“Aktivitet ekonomik” nënkupton një aktivitet të filluar për qëllim të realizimit të të ardhurave.

“Pasqyra Financiare” nënkupton pasqyrat financiare me qëllim të përgjithshëm të përgatitura në përputhje me Rregulloren Nr.2001/30 të UNMIK-ut të datës 29 Tetor 2001 mbi Vendorsjen e Bordit Raportues Financiar të Kosovës dhe Raportimin Financiar të Organizatave të Biznesit.

“Të Ardhura nga Burim i Jashtëm” nënkupton të ardhurat bruto që nuk vijnë nga një burim Kosovar i të ardhurave.

“Të Ardhurat Bruto” nënkupton të gjitha të ardhurat e realizuara apo të akruara që përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në: të ardhurat nga aktivitetet prodhuese, tregtare, financiare, investuese, profesionale apo aktivitete të tjera ekonomike brënda periudhës tatimore, pavarësisht nga koha e arkëtimit të tyre.

“Pasuri e Patrupëzuar” nënkupton patentat, të drejtat e autorit, licencat, franshizat dhe çdo pasuri tjetër që konsiston vetëm në të drejtat dhe që nuk kanë formë fizike.

“Të Ardhurat nga Burimi i Kosovës” nënkupton të ardhurat bruto që lindin në Kosovë, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- a) Interesi nga obligacionet e borxhit të lëshuara nga një kompani rezidente apo nga një trup qeveritar në Kosovë;
- b) Dividentët nga një kompani rezidente;
- c) Të ardhurat nga puna dhe shërbimet e kryera në Kosovë;

- d) Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së tundshme ose të patundshme në Kosovë;
- e) Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së patrupëzuar në Kosovë;
- f) Fitimi nga shitja e pasurisë së patundshme me vendndodhje në Kosovë;
- g) Fitimi nga shitja e pasurisë së tundshme (përveç stoqeve) kur shitësi është rezident në Kosovë; dhe
- h) Primet për sigurimin apo risigurimin nga rreziqet në Kosovë.

“Jorezident” nënkupton një person apo grup personash që nuk janë rezidentë në Kosovë.

“Njësi e përhershme” nënkupton çdo vend-pune nëpërmjet të cilit personi jorezident kryen biznes në Kosovë. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: uzinat, zyrat degë, zyrat përfaqësuese, fabrikat, punishtet dhe vendet e ndërtimit.

“Person” nënkupton një person natyral ose një person juridik.

“Person i lidhur” nënkupton një person me marrëdhënie të veçanta me personin e tatueshëm. Personat do të gjykohen si të lidhur vetëm nëse:

- (a) Ata janë zyrtarë apo drejtorë të biznesit të njëri-tjetrit;
- (b) Ata janë partnerë të njohur ligjërisht në biznes;
- (c) Ata kanë marrëdhënie punëdhënës-i punësuar;
- (d) Nje person në mënyrë direkte apo indirekte zotëron, kontrollon apo mban 50% apo më tepër të aksioneve ose të të drejtave të votës në një kompani; në këtë rast personi dhe kompania do të gjykohen si të lidhur;
- (e) Njëri prej tyre në mënyrë direkte apo indirekte kontrollon tjetrin;
- (f) Të dy kontrollohen në mënyrë direkte apo indirekte nga një person i tretë i përbashkët; apo
- (g) Ata janë anëtarë të të njëjtës familje, duke përfshirë bashkëshorten/in, stërgjyshen/in, pasardhësen/in, motrën apo vëllain, nipin apo mbesën, bashkëshortin/en e motrës ose vëllait, motra ose vëllai i prindit, apo vjehrrit, kunati ose kunata.

“Shpenzimet e përfaqesimit” nënkuptojnë të gjitha kostot që kanë të bëjnë me reklamimin e biznesit ose produkteve të tij dhe përfshijne por nuk kufizohen vetëm në kostot për publicitet, reklamim, argëtim dhe përfaqësim.

“Rezident” nënkupton një person apo grup personash që është themeluar në Kosovë apo që ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në Kosovë.

“Administrata Tatimore” nënkupton administratën në kuadër të Autoritetit Qëndror Fiskal me pushtetin e caktuar në Rregulloren No. 2000/20 të UNMIK-ut dhe instrumentet plotësuese.

“Periudha Tatimore” nënkupton vitin kalendarik.

Neni 2

Tatimpaguesit

2.1. Sipas kësaj rregullore tatimpagues do të jenë personat e mëposhtëm:

(a) Një organizatë biznesi që kërkohet të përgatisë pasqyra financiare në përputhje me Rregulloren Nr.2001/30 të UNMIK-ut;

(b) Një organizatë biznesi që vendos të përgatisë pasqyra financiare në përputhje me Rregulloren Nr.2001/30 të UNMIK-ut;

(c) Një njësi e përhershme e një personi jorezident; dhe

(d) Një organizatë e rregjistruar në UNMIK si organizatë joqeveritare sipas Rregullore 1999/22 të UNMIK, të datës 15 Nëntor 1999 mbi Rregjistrimin dhe Operimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Kosovë.

2.2 Tatimpaguesit sipas kësaj rregulloreje nuk do të jenë subjekt i tatimit të paragjykuar sipas Rregullore Nr.2000/29 të UNMIK-ut të dates 20 Maj 2000, mbi Vendosjen e Tatimit të Paragjykuar.

Neni 3

Tatimi në Fitim

3.1 Prej 1 Prill 2002 do të vendoset tatimi në fitim mbi fitimin e tatueshëm të tatimpaguesve në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.

3.2 Tatimi në fitim do të vendoset në përqindjen prej 20% mbi fitimin e tatueshëm të tatimpaguesve.

Neni 4

Fitimi i Tatueshëm

4.1. Fitimi i tatueshëm do të përcaktohet duke axhustuar të ardhurat dhe shpenzimet e tatimpaguesit të cilat janë të regjistruara në pasqyrat financiare në mënyrën e përshkruar në këtë rregullore, përveç se kur kanë lidhje me tatimpaguesit e përmendur në Pikën 2.1 (d) dhe Nenin 27 të kësaj rregullore.

4.2. Fitimi i tatueshëm për një tatimpagues rezident do të përfshijë fitimin e tatueshëm nga të ardhurat nga burimi i Kosovës dhe nga të ardhurat nga burimi i jashtëm.

4.3. Fitimi i tatueshëm për një tatimpagues jorezident do të përfshijë vetëm fitimin e tatueshëm nga të ardhurat nga burimi i Kosovës.

KAPITULLI II – TE ARDHURAT E PERJASHTUARA NGA TATIMI NE FITIM

Neni 5

Të Ardhurat e Perjashtuara

Të ardhurat vijuese do të jenë të perjashtuara nga Tatimi në Fitim:

(a) Të ardhurat e organizatave të regjistruara në UNMIK si organizata joqeveritare me status të përfitimit publik me kusht që të ardhurat të jenë shfrytëzuar ekskluzivisht për qëllim të përfitimit publik;

(b) Të ardhurat e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës;

(c) Dividentët që një tatimpagues rezident merr nga një kompani rezidente e cila ka paguar tatimin në fitim në Kosovë; dhe

(d) Të ardhurat nga një kontraktues, përveç kontraktuesve vendas, të gjeneruara nga kontratat për furnizim mallrash dhe shërbimesh për Kombet e Bashkuara (përfshi dhe UNMIK-un), Agjensitë e Specializuara të KB dhe Agjensinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike.

KAPITULLI III - SHPENZIMET

Neni 6

Shpenzimet e Lejueshme

6.1 Subjekt i kufizimeve në rregulloren e tanishme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, një tatimpaguesit, do t'i njihen si të zbritshme nga të ardhurat bruto shpenzimet e paguara apo të ndodhura gjatë periudhës tatimore tërësisht dhe ekskluzivisht në lidhje me aktivitetet e tij ekonomike.

6.2 Nuk do të lejohet zbritje për ndonjë shpenzim derisa nuk dokumentohet në mënyrën e kërkuar nga udhëzimi administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

Neni 7

Shpenzimet e Palejueshme

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, shpenzimet vijuese janë të palejueshme:

- (a) Kostoja për blerjen dhe përmirësimin e tokës;
- (b) Kostoja për blerje, përmirësim, rinovim dhe rindërtim të aseteve që janë të zhvlerësueshme apo të amortizueshme sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje;
- (c) Gjobat dhe ndëshkimet;
- (d) Tatimi mbi të ardhura, tatimi në fitim dhe tatimi i paragjykuar; dhe
- (e) Tatimi mbi vlerën e shtuar për të cilën tatimpaguesi kërkon rikthim ose kreditim të tatimit të zbritshëm sipas Rregullores 2001/11 të UNMIK-ut, të datës 31 Maj 2001, Per Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Kosovë.

Neni 8

Kontributet Bamirëse

Kontributet e kryera për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe sportive janë të lejuara si shpenzime sipas kësaj rregulloreje deri në një maksimum prej pesë përqind (5%) të fitimit të tatueshëm të llogaritur përpara se të jetë zbritur shpenzimi.

Neni 9

Shpenzimet e Përfaqësimit

Shpenzimet e përfaqësimit janë të lejueshme si shpenzime sipas kësaj rregulloreje deri në një maksimum prej dy përqind (2%) të qarkullimit të përgjithshëm.

Neni 10

Borxhi i Keq

10.1 Sipas kësaj rregulloreje borxh i keq do të konsiderohet një shpenzim që plotëson tri kushtet vijuese:

- (a) Shuma që korrespondon me borxhin është përfshirë paraprakisht në të ardhurat;

(b) Borxhet janë fshire nga librat e tatimpaguesit si të pavlefshme; dhe

(c) Egziston evidencë e përshtashme e përpjekjeve të pasuksesshme thelbësore të bëra nga tatimpaguesi për të mbledhur borxhin.

10.2 Borxhet e këqija që janë zbritur si shpenzim dhe pastaj janë arketuar më vonë do të përfshihen si të hyra në momentin kur ato janë arketuar.

Neni 11 Fondet Rezervë

11.1 Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë rregullore, kontributet për fondet rezervë nuk janë të lejueshme si shpenzime.

11.2 Bankat kanë të drejtë për shpenzime për krijimin e fondit special rezervë për asetet e pasigurta të bankës, të një shume që nuk tejkalon maksimumin e shumës së lejuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës.

11.3 Në vijim të krijimit të fondit special rezervë, çdo shumë e tërhequr nga fondi do të përfshihet në të ardhura dhe çdo shumë e kthyer në fond, për të plotësuar atë në shumën e lejueshme, do të lejohet si shpenzim i zbritshëm.

Neni 12 Pagesat për Personat e Lidhur

12.1 Kompensimet apo pagesat e paguara personit të lidhur do të lejohen si shpenzim i zbritshëm në një shumë të barabartë me çmimin e tregut.

12.2 Interesi, qeraja dhe shpenzimet e tjera të paguara personit të lidhur do të lejohen si shpenzime në një shumë që do të mund të gjendej në tregun e hapur.

Neni 13 Amortizimi

13.1 Shpenzimet për pronën e trupëzuar (përveç shpenzimeve për tokën, punimet e artit, dhe pronë tjetër që nuk konsumohet me kalimin e kohës), në pronësi të tatimpaguesit dhe të shfrytëzuar për aktivitet ekonomik të tatimpaguesit, do të zëvendësohen në kohë me zbritjet e amortizimit në mënyrën e përshkruar në këtë nen.

13.2 Të gjitha pasuritë e trupëzuara të tatimpaguesit (që i nënshtrohen amortizimit sipas nenit 13.1) do të vendosen në një rën prej kategorive vijuese:

(a) Kategoria 1: Ndërtesat dhe strukturat e tjera ndërtimore.

(b) Kategoria 2: Automobilot dhe kamionat e lehtë; kompjuterët, rrjetet dhe pajisjet e tjera procesuese të të dhënave; mobiljet e zyrës dhe pajisjet e zyrës; instrumentet, gjëra të ndryshme dhe pajisje të tjera ndihmëse; dhe

(c) Kategoria 3: Uzina dhe makineria, automjetet e rënda transportuese, pajisjet lëvizëse te dheut, automjetet e tjera të rënda, inventari hekurudhor dhe lokomotivat e shfrytëzuara për transportin hekurudhor, aeroplanët, anijet dhe prona të tjera të trupëzuara.

13.3 Pronat në secilën kategori do të trajtohet si vijon:

(a) Prona e Kategorisë 1 do të pasqyrohet në llogari individuale të aseteve;

(b) Prona e Kategorisë 2 do të vendoset në një grup të përbashkët dhe do të ketë një llogari të konsoliduar kapitali; dhe

(c) Pronat e Kategorisë 3 do të vendosen në një grup të përbashkët dhe do të kenë një llogari të konsoliduar kapitali.

13.4 Shuma e lejuar si zbritje nga amortizimi për periudhën tatimore do të përcaktohet duke aplikuar mbi llogarinë e kapitalit për secilën kategori në mbyllje të periudhës tatimore, përqindjet vijuese:

(a) Kategoria 1 – pesë përqind (5%);

(b) Kategoria 2 – njëzet përqind (20%); dhe

(c) Kategoria 3 – pesëmbëdhjetë përqind (15%).

13.5 Një aset do të merret parasysh për qëllime të këtij neni kur ai është vendosur në funksionim për herë të parë.

13.6 Shtesa fillestare në llogarinë kapitale, për çdo aset të blerë gjatë vitit, do të jetë shpenzimi për blerjen e tij plus sigurimin dhe transportin. Shtesa fillestare në llogarinë kapitale për çdo pasuri të ndërtuar nga tatimpaguesi, do të përfshijë tatimet, detyrimet dhe interesin e atribueshëm asaj prone për periudhat përpara se prona të jetë vënë në shërbim.

13.7 Shuma fillestare në llogarinë kapitale për asetet e zotëruara përpara 1 Janarit 2002 do të jetë vlera kontabël e këtyre aseteve në 1 Janar 2002.

13.8 Shpenzimet për një aset që i përket kategorisë 2 apo kategorisë 3 dhe që janë më pak se 1,000 Euro do të lejohen si shpenzim korrente.

Neni 14

Akordime të Veçanta për Asetet e Reja

Në qoftë se tatimpaguesi blen ndonjë aset që i përket Kategorisë 3, për qëllim të aktivitetit ekonomik të tatimpaguesit, në periudhën mes 1 Janarit 2002 dhe 31 Dhjetorit 2006, do të lejohet një zbritje speciale prej 5% të kostos për blerjen e asetit në vitin në të cilin është vendosur aseti në përdorim për herë të parë. Kjo zbritje do të jetë shtesë mbi zbritjen normale të amortizimit të lejuar. Zbritja do të lejohet vetëm nëse aseti është i ri apo është vënë në shërbim në Kosovë për të parën herë. Zbritja nuk do të lejohet nëse aseti është transferuar nga biznesi ekzistues apo i mëparshëm në Kosovë.

Neni 15

Riparimet dhe Përmirësimet

Në rastin e llogarive individuale të asetëve dhe llogarive në grup të asetëve:

(a) Në masën derisa shumat e shpenzuara gjatë periudhës tatimore për të riparuar, mirëmbajtur apo përmirësuar pronën nuk tejkalojnë 5 përqind (5%) të balansit në llogari në fillim të vitit, shumat e tilla do të lejohen si zbritje për atë vit; dhe

(b) Në masën derisa shumat e tilla tejkalojnë 5 përqind (5%), tejkalimi i tillë do të trajtohet si përmirësim dhe do të shtohet në llogarinë individuale ose të grupit të asetëve.

Neni 16

Zhvleresimi

16.1 Shpenzimet për asetet e patrupëzuara që kanë kohëzgjatje të përdorimit të kufizuar (përfshirë patentat, të drejtat e autorit, liçensat për vizatime dhe modele, kontratat dhe franshizat) janë të zbritshme në formën e shpenzimeve të zhvleresimit .

16.2 Metoda e zhvleresimit do të jetë metoda lineare e drejtëpërdrejte dhe shpenzimi zhvleresues do të llogaritet bazuar në kohëzgjatjen e përdorimit të asetit sikurse është përcaktuar me marrëveshjen ligjore që rregullon blerjen dhe përdorimin e asetit të patrupëzuar.

Neni 17

Kostot e Eksplorimit dhe Zhvillimit

17.1 Të gjitha kostot e eksplorimit dhe zhvillimit në lidhje me depozitën natyrore të mineraleve dhe burimeve të tjera natyrore (dhe interesi i atribuar në lidhje me të) do të shtohet në llogarinë kapitale dhe do të zhvleresohen sipas këtij neni.

17.2 Shuma e lejuar si një zbritje zhvleresimi në lidhje me kostot e eksplorimit dhe zhvillimit që përmenden në nenin 17.1 për periudhën tatimore do të përcaktohet duke shumëzuar balancin në llogarinë e kapitalit me thyesën,

(a) Numëruesi i së cilës është njësia e prodhuar nga depozita natyrore gjatë vitit; dhe

(b) Emëruesi i së cilës është prodhimi i përgjithshëm i vlerësuar nga depozita natyrore mbi jetën e përdorshmërisë së asetit.

17.3 Njësitë totale të llogaritura që do të nxirren sipas nenit 17.2 (b) do të përcaktohen në mënyrën që do të përshkruhet nga një udhëzim i ardhshëm administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

KAPITULLI IV – FITIMET DHE HUMBJET KAPITALE, HUMBJET BIZNESORE

Neni 18

Fitimet dhe Humbjet Kapitale

18.1 Fitim kapital nënkupon të ardhurat që tatimpaguesi i realizon nëpërmjet shitjes apo tjetërsimit të asetëve duke përfshirë pronën e patundshme dhe letrat me vlerë.

18.2 Shuma e fitimit kapital është ndryshimi pozitiv midis çmimit të shitjes të asetit dhe kostos së asetit sikurse është përcaktuar sipas nenit 18.7.

18.3 Humbje kapitale nënkupton një humbje që tatimpaguesi e realizon nëpërmjet shitjes apo tjetërsimit të asetit duke përfshirë pronën e patundshme dhe letrat me vlerë.

18.4 Shuma e humbjes kapitale është ndryshimi negativ midis çmimit të shitjes të asetit dhe kostos së asetit sikurse është përcaktuar sipas nenit 18.7.

18.5 Çmimi i shitjes i një aseti do të jetë shuma e çdo paraje të marrë plus vlera e tregut të hapur e çdo pasurie tjetër (përveç parasë) të marrë si konsideratë për shitjen.

18.6 Në qoftë se çmimi i shitjes është më i ulët se çmimi i tregut, për qëllimet e këtij neni, çmimi i shitjes do të jetë çmimi i tregut.

18.7 Kostoja e asetit është shuma që ka paguar tatimpaguesi për blerjen e asetit, e rritur nga kostoja e përmirësimeve dhe e zvogëluar nga amortizimi dhe shpenzimet e tjera qofshin të aplikueshme në pasqyrat financiare apo të lejueshme sipas kësaj Rregulloreje.

18.8 Ky nen nuk zbatohet për asetet që i nënshtrohen amortizimit si asete të grupit.

18.9 Fitimet kapitale do të njihen si të ardhura biznesi dhe humbjet kapitale si humbje biznesi.

Neni 19

Shndërrimet e pavullnetshme

Fitimi kapital nuk do të njihet në rastin e shndërrimit të pavullnetshëm të pronës derisa ajo konsideratë e marrë nga ky shndërrim përmban ose pasuri të karakterit apo natyrës së njëjtë apo para që janë investuar në pasuri të të njëjtit karakter apo natyrë brënda një periudhe të zëvendësimit prej dy (2) vjetësh.

Neni 20

Humbjet Biznesore

20.1 Humbje biznesore është ndryshimi negativ ndërmjet të ardhurave të tatimpaguesit dhe shpenzimeve që lindin nga aktiviteti ekonomik.

20.2 Shuma e humbjes biznesore e përcaktuar sipas këtij neni do të mbartet në secilën prej pesë (5) periudhave tatimore të ardhshme dhe do të jetë e disponueshme si zbritje ndaj çdo të ardhure në ato vite.

20.3 Shuma e mbartur e humbjes që merret parasysh për çdo periudhë tatimore pas vitit të humbjes biznesore do të jetë tërë shuma e humbjes, e zvogeluar me shumën agregate të lejuar më parë si një zbritje.

20.4 Në qoftë se tatimpaguesi ka humbje biznesore në më tepër se një (1) vit, ky nen do të zbatohet për humbjet sipas rendit që ato kanë lindur.

KAPITULLI V – ORGANIZIMET, RIORGANIZIMET DHE LIKUIDIMET

Neni 21

Shperndarja e Pasurisë

21.1 Një kompani që shperndan pasuri (përveç aksioneve) tek një aksioner në lidhje me interesin e aksionerit do të njohë fitim apo humbje njelloj sikur pasuria e tillë t'i ishte shitur aksionerit me vlerën e tregut të hapur.

21.2 Vlera e pasurisë së aksionerit është vlera e tregut të hapur të pasurisë.

21.3 Në rastin e shperndarjes së dividendëve të aksioneve, kur nuk ndryshon masa e pjesëmarrjes së perfituesit, kompania nuk njih fitim apo humbje dhe aksioneri nuk realizon të ardhura.

Neni 22
Likuidimi

22.1 Në rastin e likuidimit të një kompanie, kompania do të marrë parasysh fitimin apo humbjen njëloj sikur të kishte shitur pasurinë e shperndare në likudim me vlerën e tregut të hapur.

22.2 Përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, marrësit e pasurisë së shperndare në likudim do të trajtohen sikur ata kanë shkëmbyer interesin e tyre aksionar në kompaninë e likuiduar për një shumë të barabartë me vlerën e tregut të hapur të pasurisë.

22.3 Në rastin e likuidimit të kompanisë bijë aty ku pasuria e kompanisë bijë i është shperndarë kompanisë mëmë, kompania mëmë nuk do të njohë ndonjë fitim apo humbje.

Neni 23
Riorganizimi

23.1 Transferimet e pasurisë në përputhje me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit (për shkak të falimentimit, shkrirjes, blerjes ose tjetër), që është aprovuar nga Administrata Tatimore, nuk do të tatohen sipas kësaj rregulloreje.

23.2 Në rast të riorganizimit, vlera kontabël e pasurisë së zotëruar nga tatimpaguesi i riorganizuar do të përcaktohet duke iu referuar vlerës kontabël të pronës së tillë menjëherë përpara riorganizimit.

23.3 Gjatë riorganizimit, shperndarja tek aksioneri ne perputhje me interesin kapital te aksionerit nuk do të përbëjë të ardhura për aksionerin.

23.4 Përveç nëse përcaktohet ndryshe me një rregullore administrative që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal, tatimpaguesi marrës do të marrë përsipër stoqet, humbjet e mbartura, llogarinë dividente dhe të gjithë artikujt e tjerë në mënyrë që tatimpaguesi marrës të zëjë vendin e tatimpaguesit të marrur në lidhje me artikujt e tillë.

**KAPITULLI VI – ÇMIMET E TRANSFERIMIT, SHMANGIA E
TATIMIT TE DYFISHTE**

Neni 24
Çmimet e Transferimit

24.1 Çmimi i përdorur në lidhje me transaksionet e aseteve apo obligimet kontraktuale ndërmjet personave të lidhur do të konsiderohet çmim transferimi.

24.2 Çmimi që pritet të pranohet në lidhje me transaksionet e aseteve apo obligimet kontraktuale ndërmjet palëve të cilat veprojnë në Gjatësinë e Krahut ose më shumë se Gjatësia e Krahut do të konsiderohet të jetë çmim në Gjatësinë e Krahut.

24.3 Çmimi në Gjatësinë e Krahut do të përcaktohet sipas metodës krahasuese të çmimit të pakontrolluar dhe kur nuk është e mundur, atëherë do të përdoret metoda e çmimit të rishitjes apo metoda e kostos plus.

24.4 Ndryshimi ndërmjet çmimit në Gjatësinë e Krahut dhe çmimit të transferimit do të përfshihet në fitimin e tatueshëm.

Neni 25

Shmangia e Tatimit të Dyfishtë

25.1 Tatimpaguesi rezident që krijon fitim nga aktivitetet e biznesit jashtë Kosovës nëpërmjet njësisë së përhershme jashtë Kosovës dhe që paguan tatimin në atë fitim në shtetin tjetër, sipas kësaj rregullore do t'i lejohet një kreditimin tatimor në një shumë të barabartë me shumën e paguar në shtetin tjetër.

25.2 Cdo kreditim tatimor sipas këtij neni është i kufizuar në shumën e tatimit mbi fitimin e realizuar në shtetin tjetër, te pagueshem sipas kësaj rregulloreje.

25.3 Çdo marrëveshje bilaterale e aplikueshme për shmangien e tatimit të dyfishtë e bërë nga Kosova me shtetin tjetër zëvendëson dispozitat e këtij neni.

KAPITULLI VII – TATIMI I MBAJTUR NE BURIM

Neni 26

Tatimi i Mbjatur në Burim për Dividentët, Interesin dhe Te Drejtat e Autorit

26.1 Tatimpaguesit që paguajnë dividendë, interes apo te drejta autori tek personat jorezidente, duhet të mbajnë në burim një tatim prej 15 përqind në momentin e pagesës, dhe këtë tatim ta transferojnë në Administratën Tatimore.

26.2 Në qoftë se shumat e tatimit nuk janë mbajtur në burim, ose janë mbajtur por nuk janë paguar, tatimpaguesi duhet të paguajë tatimin e pambajtur në burim ose të papaguar tek Administrata Tatimore, poashtu edhe interesin e lidhur me të dhe ndëshkimet për periudhën e mospageses.

KAPITULLI VIII – DISPOZITA TE VEÇANTA

Neni 27

Trajtimi i Kompanive të Sigurimit

Në rastin e ndonjë entiteti, aktiviteti kryesor i të cilit është sigurimi apo risigurimi i jetës, pronës apo rreziqeve të tjera, tatimi i vendosur nga kjo rregullore do të jetë shuma prej shtatë përqind (7%) e primeve bruto të akruara gjatë periudhës tatimore.

KAPITULLI IX – DISPOZITAT ADMINISTRATIVE

Neni 28

Deklarata Tatimore

28.1 Tatimpaguesit duhet t'i dorëzojnë Administratës Tatimore një deklaratë tatimore në formën që do të caktohet në udhëzimet administrative që do të lëshohen nga Autoriteti Qëndror Fiskal më ose përpara 1 Prill të vitit që pason periudhën tatimore.

28.2 Tatimpaguesit duhet t'i dorëzojnë Administratës Tatimore pasqyrat financiare të kërkuara nga Rregullorja Nr.2001/30 e UNMIK-ut, së bashku me deklaratën tatimore.

Neni 29

Pagesa e Tatimit dhe Interesi për Pages te Vonuar

29.1 Çdo tatimpagues duhet të bëjë pagesën e tatimit në këste tremujore më ose përpara 15 Prill, 15 Korrik, 15 Tetor, dhe 15 Janar në lidhje me tremujorin kalendarik që paraprin këto data. Shuma që detyrohen për çdo këst tremujor do të jetë një e katërta e tatimit total për atë periudhë tatimore, duke u bazuar ose në shumën e llogaritur të fitimit të tatueshëm për periudhën tatimore, ose në fitimin e tatueshëm të vlerësuar për vitin paraprak përveç se për periudhën tatimore 2002, si edhe për periudhën e parë tatimore të nje tatimpaguesi, detyrimi tatimor sipas këtij neni do të bazohet në shumën e llogaritur të fitimit të tatueshëm.

29.2 Çdo tatimpagues duhet të përgatisë një pasqyrë përfundimtare të vlerësimit të tatimit dhe të paguajë shumën përfundimtare më ose përpara 1 Prill të vitit që pason periudhën tatimore. Shuma e caktuar ne pasqyrën përfundimtare do të jetë ndryshimi ndërmjet tatimit të përcaktuar për periudhën tatimore në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore dhe totalit të shumave të paguara në këstet tremujore.

29.3 Nëse totali i shumave të paguara në këstet tremujore është më i madh se tatimi i vlerësuar rrjedhimisht nga Administrata Tatimore, tatimpaguesi ka të drejtën e një rimbursimi të tatimit të paguar teper.

29.4 Nëse tatimpaguesi dështon të paguajë shumën e caktuar për këstin tremujor, ose për pasqyrën përfundimtare të vlerësimit, ose vonon të bëjë këto pagesa, do t'i aplikohet një interes sa ndryshimi ndërmjet shumës së caktuar dhe shumës së paguar, në përputhje me përqindjet komerciale të huasë në Kosovë siç do të lajmërohet publikisht herë pas here nga Administrata Tatimore. Rrjedhimisht, tatimpaguesi mund të ndëshkohet sipas nenit 31 të kësaj rregullore.

29.5 Nëse pagesat e kësteve tremujore bëhen në datat e caktuara ose më përpara, dhe pasqyra përfundimtare e vlerësimit bëhet siç kërkohet në nenin 29.2 të kësaj rregullore, nuk do të aplikohet interes ose ndëshkime për pagesat e pamjaftueshme, nëse:

(a) Ndryshimi ndërmjet shumës për t'u paguar në çdo këst tremujor dhe shumës së paguar për çdo këst nuk është më i madh se dhjetë përqind (10%) e shumës së duhur; ose

(b) Pas periudhës tatimore 2002 dhe pas periudhës së parë tatimore të tatimpaguesit, shuma e paguar në çdo këst është dhjetë përqind (10%) më e lartë se një e katërta (1/4)e tatimit të vlerësuar nga Administrata Tatimore për periudhën paraprake tatimore.

Neni 30

Inspektimi i Regjistrimeve, Vlerësimet, Mbledhja e Detyrueshme

Në përputhje me Rregulloren Nr.2000/20 të UNMIK-ut dhe instrumentet shtesë:

(a) Administrata Tatimore mund të kërkojë prodhimin e dokumenteve apo informatave të tjera lidhur me të hyrat, shpenzimet, asetet e amortizueshme dhe informata të tjera që kanë lidhje me llogaritjen e fitimit të tatueshëm;

(b) Administrata Tatimore mund të lëshojë një njoftim mbi vlerësimin dhe kërkesën për pagesë për personat të cilët dështojnë të dorëzojnë deklaratën apo të bëjnë pagesën tremujore të vlerësuar korrektësisht apo pagesën finale; dhe

(c) Administrata Tatimore mund të përdorë metodat e mbledhjes së detyrueshme për mbledhjen e tatimit nëse tatimpaguesi dështon të paguajë shumën korrekte të tatimit që ka borxh brënda kohës së përshkruar.

Neni 31

Shkeljet dhe Ndëshkimet

Çdo person që kryen shkelje të kësaj rregullore do t'i nënshtrohet ndëshkimeve të përcaktuara nga ligji i aplikueshëm, duke përfshirë ato ndëshkime të dhëna në Rregulloren Nr. 2000/20 të UNMIK-ut dhe instrumentet shtesë.

Neni 32
Ankesat

Çdo person i ndikuar drejtpërdrejt nga një përkufizim zyrtar i kësaj rregullore mund të bëjë ankesë për përkufizimin e tillë duke u bazuar në Rregulloren Nr. 2000/20 të UNMIK-ut dhe instrumenteve shtesë.

KAPITULLI X – DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Neni 33
Ligji i Aplikueshëm

Kjo rregullore do të zëvendësojë çdo dispozitë në ligjin e aplikueshëm që nuk pajtohet me të.

Neni 34
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë direktiva administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi më 20 Shkurt 2002.

Michael Steiner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

